REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE**
**DREJTORIA E TRAJTIMIT TË KËRKESAVE PËR NJOHJE PRONËSIE**

Nr. 709/1 prot. Tiranë, më 06.02.2026

Lënda: Kërkesë për afishimin e shpalljes

BASHKIA MA
Zyra e Protokollit
Nr. 652 Prot
Date 9.2.26 Gjykrimi

**BASHKISË MALIQ**

Në zbatim të dispozitave të Kodit të Proçedurave Administrative, ligjit nr. 133, datë 05.12.2015 *"Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit"*, i ndryshuar, dhe VKM-së nr.222, datë 23.03.2016 *"Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës"* e ndryshuar, pika 6 e saj, ku është parashikuar se "*Kur ATP-ja konstaton mangësi në dokumentacionin shoqërues të kërkesës, njofton kërkuesin me postë të porositur që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, të plotësojë pasaktësitë. Kur kërkuesi nuk ka marrë dijeni për mangësitë në dokumentacionin shoqërues të kërkesës, ATP-ja kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për vendbanimin e kërkuesit, me qëllim kryerjen e njoftimit përmes postës së porositur*". *Kur njoftimi nuk është i mundur ose vendbanimi i kërkuesit nuk është i njohur, njoftimi bëhet me shpallje në selinë e ATP-së, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet prona, objekt pretendimi, si dhe në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin. Njoftimi vlerësohet i kryer pas 10 (dhjetë) ditëve nga data e shpalljes, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative,* kërkojmë nga ana juaj që shpalljen bashkëlidhur kësaj shkrese për njoftimin e subjekteve për pjesëmarrje në procedimin administrativ ta afishoni në "Këndin e Njoftimeve".

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV. DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Benard PALAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE - MINISTRIA E DREJTËSISË

-ST HP
dt 09.02.2026



Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE**
**DREJTORIA E TRAJTIMIT TË KËRKESAVE PËR NJOHJE PRONËSIE**

Nr.700 prot. Tiranë, më 06.02.2026

**SHPALLJE**

**PËR**
**NJOFTIMIN E SUBJEKTIT PËR PJESËMARRJE NË PROCEDIM ADMINISTRATIV**

**PËR BASHKINË MALIQ**

Në Agjencinë e Trajtimit të Pronave Tiranë (ATP), është duke u shqyrtuar kërkesa/praktika me të dhënat si më poshtë:

| Nr. Rendor | Nr. Kërkese/ Praktike | Data | Qarku | Emri subjektit të shpronësuar | Mbiemri | Emri subjektit kërkues | Atësia | Mbiemri |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 979 | 29.03.2016 | Korçë | Emin | Kafazi | Like | Emin | Kafazi |

Duke qenë se në dosjet e mësipërme, njoftimi i kërkuesit nuk është i mundur ose vendbanimi i kërkuesit nuk është i njohur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, në zbatim të dispozitave të Kodit të Proçedurave Administrative, ligjit nr. 133, datë 05.12.2015 *"Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit"*, i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 222, datë 23.03.2016 *"Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës"* e ndryshuar, bën njoftimin me shpallje në selinë e ATP-së, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet prona, objekt pretendimi, si dhe në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin, për të njoftuar subjektin kërkues për procedimin administrativ të hapur dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

**Subjekti kërkues për procedimin administrativ të sipërcituar duhet të paraqitet në Drejtorinë e Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie, pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, në adresën: *Rruga "Muhamet Gjollesha", nr. 54, Tiranë.***

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV. DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Benard PALAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E DREJTËSISË - AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE - DREJTORIA E TRAJTIMIT TË KËRKESAVE PËR NJOHJE PRONËSIE - TIRANË



Scanned with CamScanner